



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 04.03.2019]

Për: Operatorin Ekonomik “Vellezerit Hysa” shpk, me NIPT K12911201C, me adrese: Fshati “Banje e Re”, Klos, Bashkia Cerrik, buze lumit Devoll, pasuria nr. 31/50.

Procedura e prokurimit: **“Tender i Hapur”** me objekt : **“Ndertimi i pedonales dhe korsise se bicikletave te Liqenit Belshit, Faza e III”**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Ndertimi i pedonales dhe korsise se bicikletave te Liqenit Belshit, Faza e III”**.

Numri i referencës së procedurës: **REF-94803-11-20-2018**.

Kohëzgjatja: brënda 10 muajsh nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: 155.703.178 (njëqind e pesëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 21.12.2018**.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	SHOQERIA	OFERTA PA TVSH PARA KONTROLLIT ARITMETIK	NIPTI
1	"FLED" SHPK	96,217,571	K17621104C
	"SHKELQIMI 07" SHPK		K68121808W
	"GRAND KONSTRUKSION M" SHPK		L38109801T
2	"KEVIN KONSTRUKSION" SHPK	96,351,774	K71401004W
3	"VELLEZERIT HYSA" SHPK	101,503,501	K12911201C
4	"BLERIMI" SHPK	105,106,042	J62903384G
	"BAJRAMI N" SHPK		K02727202O
5	"KACDEDJA" SHPK	108,925,852	K51712017A
	AGRI CONSTRUCTION SHPK		K01725001F
6	"EURONDERTIM 2000" SHPK	112,871,557	K02003001O
7	"LIQENI VII" SHPK	127,284,230	K01730502W
	"KUPA" SHPK		K51615512C
8	"KTHELLA" SHPK	129,499,428	J69303023D
9	"CURRI" SHPK	132,210,134	J67902718S
10	"ISOBAR CONSTRUCTION" SHPK	PA OFERTE	L12210036D



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

Pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur komisioni me unanimitet vendosi:

1. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Fled” shpk (43%), “Grand Konstruksion” shpk (37%) dhe “Shkelqimi 07” shpk (20%) pasi:

Shoqeria “Fled” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi, sipas kerkesave per kualifikim, duhet te kishte realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, ose nje pune me vlere jo me pak se 77.851.589 leke pa tvsh (duke qene se eshte anetari i bashkimit me perqindjen me te madhe ne bashkimin e shoqerive) ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlere monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 200% e vleres se fondit limit ose me vlere jo me pak se 133.904.733 leke pa tvsh (bazuar ne perqindjen e punes qe ka marre persiper ne bashkim). Kjo shoqeri ka deklaruar se ka realizuar objektin “Rikonstruksion i pjesshem i rrugeve ne bashkine Mallakaster” me vlere 61.847.800 leke pa tvsh duke mos plotesuar kushtet.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

2. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk pasi:

Shoqeria “Kevin Konstruksion” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.3 per kualifikim lidhur me detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, pasi referuar puneve te ngjashme te deklaruara ka kryer aktivitet ne Kukes ne objektin “Rruga Borje – kufi me Kosovën” dhe nuk ka paguar detyrimet vendore.

Shoqeria “Kevin Konstruksion” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme pasi ka paraqitur dy kontratat: “Rikualifikim urban i bllokut kufizuar nga rruga “Ibrahim Rugova”, “Pjeter Bogdani” “Gjin Bue Shpata” dhe bulevardit “Bajram Curri” me vlere 39.762.162 leke pa tvsh dhe “Rruga Borje – kufi me Kosoven” me vlere 53.317.647 leke pa tvsh.

Me keta dy objekte nuk ploteson asnje prej kushteve pasi vlere e objektit me te madh te deklaruar eshte 53.317.647 leke pa tvsh nga 77.851.589 leke pa tvsh qe eshte kerkesa dhe vlere e plote e te dy objekteve te deklaruar eshte 93.079.809 leke pa tvsh nga 311.406.356 leke pa tvsh qe eshte kerkesa (bazuar ne perqindjen e puneve qe ka marre persiper).

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

3. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Blerimi” shpk (19%) dhe “Bajrami N” shpk (81%) pasi:

Shoqeria “Blerimi” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.3 per kualifikim lidhur me detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, pasi referuar puneve ne proces te deklaruara ne nje procedure tjeter te zhvilluar ne FSHZH (“Rivitalizimi urban i bulevardit Maliq - Drithas ”), gjate vitit 2018 ka kryer aktivitet ne Vaun e Dejes ne objektin “Rehabilitimi i galerive te drenazhit dhe thellesise brenda nderteses se centralit, sistemit te ndricimit dhe shkalleve ne HEC Vau i Dejes” dhe nuk ka paguar detyrimet vendore.



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

4. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Isobar Construction” shpk pasi:

Nuk ka paraqitur dokumentacion per kualifikim.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin Ekonomik “Vellezerit Hysa” shpk**, me NIPT K12911201C, me adrese: Fshati “Banje e Re”, Klos, Bashkia Cerrik, buze lumit Devoll, pasuria nr. 31/50, se oferta e paraqitur, me vlerë **101,503,501 (njqind e nje milion e peseqind e tre mije e peseqind e nje) lekë** pa TVSH është identifikuar si oferta e sukseshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **09.01.2019**.

Ne daten 16.01.2019 paraqiti ankim shoqeria “Kevin Konstruksion” shpk. Ankimit ju kthye pergjigje ne daten 17.01.2019 duke e refuzuar ate.

Ne daten 25.01.2019 operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” sh.p.k paraqiti ankim prane Komisionit te Prokurimit Publik. Autoriteti Kontraktor me shkresen nr.63/1, date 30.01.2019, dorezoi prane K.P.P informacionin e kerkuar ne lidhje me kete procedure prokurimi.

Komisioni i Prokurimit Publik, me Vendimin nr. 126 prot., date 25.01.2019, vendosi te mos pranoje ankimin e paraqitur nga operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” sh.p.k, dhe lejimin nga ana e Autoritetit Kontraktor per vijimin me hapat e metejshme te procedures.